



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 146-19
Me 07.11.2019
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja (b) dhe (g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 12 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dhe nenit 81 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet e Organizatave Jo Qeveritare (OJQ) në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit në Komunën e Mamushës.

I

1.1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF- NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

1.2. Mbështetja financiare publike për projektet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Komunës së Mamushës, kodi ekonomik 85014.

II

Mjetet e përmendura në nenin 1.2. të këtij vendimi do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

III

Obligohet Drejtoria e Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Me vendim njoftohen:

- 1.Drejtoria e Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport
- 2.Drejtoria e Financave
- 3.Arkiva.

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opstina Mamusa – Municipality of Mamusa



DREJTORIA PER ARSIM, KULTURE, RINI DHE SPORT

07.11.2019

Në mbështetje të nenit 4 nenit 13 lidhur me nenin 10, 11 dhe 13, të Rregullores MF-NR-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publike të OJQ-ve, Drejtoria për Arsım, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Mamushës, bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PER APLIKIM

Komuna e Mamushës, përkatësisht Drejtoria për Arsım, Kulturë, Rini dhe Sport, permes kësaj shkrese ju bën thirrje publike për aplikim të gjitha OJQ-ve, të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë Brenda Komunës së Mamushës dhe që fushëveprimtari kanë kulturën, rininë dhe sportin, të aplikojnë për mbështetje financiare nga subvencionet e Drejtorisë për Arsım, Kulturë, Rini dhe Sport.

QELLIMI;

Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është subvencionimi dhe mbështetja financiare për klubet e sportit, OJQ-të rinore e kulturore për zhvillimin e aktiviteteve nga fushëveprimtaria e tyre.

- **Projektet nga fusha e kulturës:** Promovimet e vlerave të festivaleve, koncerteve, shënimin e datave historike dhe kulturore, simpoziumet, ekspozitave dhe promovimin e librave për botim.
- **Projektet në fushën e sportit:** Masovizimi i sportit për të rinjë.

- **Porjektet në fushën e rinisë:** Promovimi i vullnetarizmit (aktivitete për shërbime të arsimit, evokim, kampanjë, menaxhment, aktivitete humanitare dhe ambiente).
- Edukim joformal
- Punësim i të rinjëve
- Fuqizim të organizatave rinore
- Infrastruktur për rinë

SPECIFIKAT TJERA TE THIRRJES PUBLIKE

- Thirrja publike për aplikim hapet më **07.11.2019** dhe mbyllet më **27.11.2019**.
- Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së afatit për aplikim nuk do të pranohen
- Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen
- Zbatimi i projekteve do të monitorohet nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DAKRS.
- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Mamushës dhe përfituesi i donacionit do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
- Me secilën OJQ që do të jetë përfituese e subvencionit do të nënshkruhet një kontratë përfituesit të mjeteve financiare dhe mbështetësit financiar.

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit;

- Aplikacioni, (sipas modelit të DAKRS -së); të tërhiqet në e DAKRS
- Projekt-propozimi, përfshirë, agjendën, aktivitetet, planifikimi dhe linja buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit.

- Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar nga OJQ-së,
- Certifikata me numër fiskal,
- Certifikata me numër të regjistrimit të biznesit
- Kopja e kartelës së xhirollogarorisë në emrin e OJQ-së dhe kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar.
- Raporti financiar i vitit paraprak 2018 *(jo vlenë vetim për klubet që kanë pranuar subvencione edhe në vitin e kaluar)*.
- Deklaratë për mos financim të dyfishtë.

Mënyra e aplikimit;

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur,
- Brenda zarfit vendosen një kopje e të gjitha dokumentacionit original të kërkuara,
- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimi në katin e parë në objektin e Komunës.

